

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti i pergjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me procesmbajtësen Blerina Haziri, në lëndën penale kundër të pandehurit, E. Sh., për shkak të dy veprave penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi të KPRK-së dhe pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, të cilin e ka mbrojtur av. Mustafë Musa, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjiilan, PP.II.nr. 1377/17, të datës 14.08.2017, të cilin e përfaqësonte prokurori i shtetit, Esat Ademi, pas mbajtjes së seancës dëgjimore më 30.08.2017, shpalli publikisht, ndërsa më 05.09.2017, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E. Sh. nga babai M. dhe nëna K., e lindur Xh., i lindur më ... në Gj., me vendbanim në fshatin S., komuna e V., ku edhe jeton, ka të kryer ..., ... punësuar,... martuar, i gjendjes së ... ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

Ë S H T Ë F A J T O R

I

Me datë ...2017 rreth orës ..., në V., në rr. "...", i pandehuri, me dashje, me veprime të rrezikshme shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzëve në atë mënyrë që derisa policia ishin duke matur shpejtësinë, me radar, ndërkohë një veturë e markës "...", ngjyrë të ... ishte duke kaluar me një shpejtësi prej 65 km në orë, në vendbanim, pasi që vetura ka tejkaluar shpejtësinë, policia ka dhënë shenjën për të ndalë veturën, mirëpo i njëjti nuk është ndalë, por përkundrazi ka rritur shpejtësinë e veturës në drejtim të qytetit, ndërsa vetura policore ka filluar ndjekjen e tij, ku i pandehuri duke ikur ka hipur edhe në trotuar, me çka ka rrezikuar edhe këmbësorët që ishin në trotuar, pasi ka humbur kontrollin mbi veturën e tij, dhe fillimisht e ka goditur një shtyllë elektrike të betonit, një shportë të mbeturinave si dhe një dru dekorative e mbjellur nga punonjësit komunal.

-Me çka ka kryer veprën penale,shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi 1 të KPRK-së,

II

Me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin një, të këtij aktvendimi, i pandehuri i pengon personat zyrtar, në kryerjen e detyrave zyrtare – të dëmtuarit V. S. dhe E. A., në atë mënyrë që, pas aksidentit, zyrtarët policor kanë tentuar ta arrestojnë të pandehurin, mirëpo i njëjti nuk iu ka bindur urdhërave policore, ka rezistuar dhe i ka penguar dy policët në vendin e ngjarjes, me ç'rast, njëri nga policët V. S., i është shqyer xhepi i djathtë i këmbës zyrtare, ku V. S. ka kërkuar ndihmë mjekësore në shtëpinë e shëndetit në V..

-Me çka ka kryer veprën penale,pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërthekësuar ligjore si dhe neneve 4, 41, 42, 46 , 73, 74, 75, 76 të KPRK-së si dhe nenit 233 dhe 365 të KPP-të pandehurit, i

S H Q I P T O N

I. Për veprën penale dispozitivi I, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 120 ditëve, i cili me pëlqimin e të pandehurit dhe në pajtim me nenin 47 të KPPRK-se, i zëvendësohet në dënimin me gjobë në shumën prej 800€ (tetëqind) Euro, të cilën gjobë i pandehuri detyrohet që t'a paguaj në afat prej 3 (tre) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të pandehurit kaha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 05.08.2017, e deri më 30.08.2017, komfor nenit 83 të KPRK-së, iu është llogaritur në dënimin e shqiptuar si më lartë.

Nëse i pandehuri në fjalë nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e përcaktuar me këtë aktgjykim, në atë rast gjykata do të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke i llogaritur 1 ditë burgim njëzet (20) Euro gjobë.

II. Për veprën penale dispozitivi II, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

I pandehuri detyrohet që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbaramit të dhunshëm.

Të dëmtuarit V. S. dhe E. A., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan – pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 1377/17, të datës 14.08.2017, kundër të pandehurit E. Sh., të cilin e ka mbrojtur, av. M. M. nga Gj., për shkak të dy veprave penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi të KPRK-së, dhe pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan me 14.08.2017 ka paraqitur marrëveshjen për praninë të fajësisë, të nënshkruar nga prokurorja e shtetit, Kujtesa Fazliu, i pandehuri E. Sh. dhe mbrojtësi i tij, av. M. M..

Gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore në të cilën kanë prezentuar prokurori ish-tetit Esat Ademi, si dhe i pandehuri E. Sh. me mbrojtësin e tij, av. M. M..

Prokurori shtetit ka deklaruar se kemi pranuar kërkesat për fillimin e negociimit për praninë e fajësisë më datë 14.08.2017, pastaj prokurori i çështjes ka marrë autorizim nga Kryeprokurori i Prokurorisë së Shtetit të PTHDP në Gjilan, Jetish Maloku dhe kemi filluar të negociojmë me të pandehurin e sipërtheksuar si dhe mbrojtësën e tij, kështu që, është arritur marrëveshja për praninë e fajësisë me të pandehurin e lartëcekur dhe mbrojtësin e tij. Prandaj mbes në tërsi pranë marrëveshjes për praninë të fajësisë nga se janë plotësuar kushtet ligjore në pajtim me nenin 233 të Kodit të procedurës penale.

Mbrojtësi i të pandehurit E. Sh., av. M. M., ka deklaruar se pas konsultimit të njaftueshëm me të mbrojturin tim, kemi marritur marrëveshjen për praninë e fajësisë, përmes së cilës është rekomanduar edhe dënimi, andaj i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje ta pranojë, sepse e njehta është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

I pandehuri E. Sh. në fjalën e tij deklaroi: në tërsi e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim, nga fakti se edhe unë jam dakorduar për marrëveshjen e arritur të cilën edhe e kam nënshkruar.

Pas dëgjimit të deklaratëve të palëve, e në mbeshtetje të nenit 233 paragrafi 21, lidhur me nenin 18 të KPPK-së, gjykata konstatoi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, andaj vendosi që të pranohet marrëveshja për pranim të fajësisë, lidhur mes PTH-së – DP, në njërën anë, dhe të pandehurit E. Sh. me mbrojtësin e tij, në anën tjetër për kryerjen e veprave penale, shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 paragrafi të KPRK-së dhe pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së. Gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në bazë të nenit 233 paragrafi 21, të KPPK-së, vendosi që data e sotme të jetë data kur palët t'i japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, e që një gjë e tillë është bërë menjëherë.

Prokurori i shtetit Esat Ademi ka deklaruar : Mbetem në tërësi pranë marrëveshjes lëndore të nënëshkrura nga palët, duke u pajtuar edhe me dënimin.

Mbrojtësi i të pandehurit E. Sh., av. M. M., deklaroi: si në fillim, por edhe tani theksoi faktin se marrëveshja është arritur në pajtim me dispozitat ligjore dhe dakordimin e të mbrojturit tim, kështu që kërkoj nga gjykata që të njejtën ta aprovoj, po ashtu me rastin e zëvendësimit e dënimin me burg në dënim me gjobë, edhe atë për veprën penale sipas dispozitivit I të aktakuzës, me numër dhe datë të shënuar si më lartë, të ketë parasysht gjendjen e vështirë ekonomike të tij, e që pagesa e dënimin me gjobë, të mbrojturit tim ti mundësohet me këste mujore në afat të arsyshëm ligjor.

I pandehuri E. Sh., deklaroi e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim pendohem për veprën e kryer, dhe në fund i premtoi gjykatës se në të ardhmën nuk do të përsëris vepra të kësaj natyre.

Pas pranimit të marrëveshjeve për pranimin të fajësisë për veprat penale të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lartë, si dhe deklaratave të palëve lidhur me dënimin, gjykata të pandehurin, e shpalli fajtor dhe në pajtim me nenin 233 paragrafi 21 i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimin ashtu që të njëjtin do ta parandalojë që të ardhmen të mos kryejë vepra të tjera penale dhe se ky dënim do të ndikojë edhe tek qytetarët e tjerë.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 paragraf. 1, në lidhje me nenin 450 paragrafi 1 nënparagrafi 2.6 të KPPK-së.

Të dëmtuarit V. S., dhe E.A., konform nenit 463 të KPPK-së, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Gjykata Themelore në Gjiilan - Departamenti i përgjithshëm
P.nr.822/17, më 05.09.2017

Procesmbajtësja
Blerina Haziri, d.v.

Gjyqtari
Islam Thaçi, d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.